



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË , KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE “HOTELERI-TURIZËM”
TIRANË**

Tiranë, më: 12/03 /2025

Nr. 99 Prot

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

**DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË Ë MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive Udhezimin” Nr.759, datë 30.09.2024, Per menyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesëve te arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit te vazhduar profesional te personelit “, shkrese per miratimin e strukturës dhe te organikës per vitin 2025, datë 28.02.2025 ,nr. 2814/2 prot, nr 278, date 28.02.2025 “Per disa ndryshime ne urdherin nr. 863 prot, datë 21.10.2024, **“PER MIRATIMIN E STRUKTURES DHE TE ORGANIKES TE SHKOLLAVE Të MESME PROFESIONALE.**

Shkolla e mesme profesionale “Hoteleri-Turizëm”, Tiranë ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

1 (nje) Instruktor / praktikë Kuzhinë **(Kohë e plotë)**

1. Krite të përgjithshme:

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

2. Kriteria të posaçme

- a) Kriteria të posaçme për personelin mësimdhënës të praktikës profesionale në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim profesional;
- b) të ketë detyrimisht diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin / kualifikimet profesionale me të cilin/ /cilat po aplikon;
- c) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- d) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

Dokumentet e aplikimit

- 1. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:
 - a) letërmotivimin për pozicionin;
 - b) jetëshkrimin (CV-në);
 - c) kartën e identitetit;
 - d) diplomën;
 - e) librezën e punës;
 - f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
 - g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
 - j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
 - k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
- 2. Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.
- 3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e institucionit, brenda datës. 21.03.2025.

Adresa: Rruga e Kavajës 50
Tel/Faks: +355 4 232 0393
e-mail :hoteleriturizem@yahoo.com

